STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për njoftim të menjëhershëm:** 29 mars 2013

**GUVERNATORI CUOMO MIRËPRET NJË SHTESË PREJ NJË MILIARD DOLLARË NGA FONDET FEDERALE PËR RIMËKËMBJEN NGA SANDY PËR AUTORITETIN E TRANSPORTIT METROPOLITAN**

Guvernatori Andrew M. Cuomo mirëpriti sot një shtesë prej një miliard dollarë për Autoritetin e Transportit Metropolitan (MTA) për të mbuluar koston e rimëkëmbjes nga super stuhia Sandy dhe për të rindërtuar elementët e dëmtuar të sistemit MTA të metrosë, autobusëve dhe hekurudhave.

Fondi prej një miliard dollarë nga Administrata Federale e Transportit (FTA) vjen si shtesë e fondit fillestar të rimbursimit prej më tepër se 193 milion dollarë të caktuara në fillim të muajit për MTA New York City Transit, MTA Metro-North Railroad dhe MTA Long Island Rail Road, si dhe 3 milion dollarë nga Agjencia Federale e Menaxhimit të Krizave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA) për urat dhe tunelet (MTA Bridges and Tunnels).

"Nju Jorku punoi shumë për të bindur Kongresin se dëmet e papara në rrjetin e sistemit jetësor të transportit meritonin ndihmën federale për tu rimëkëmbur", tha guvernatori Cuomo. "Jam i lumtur që MTA vazhdon të marrë ndihmën e nevojshme në formën e rimbursimeve për koston e shkaktuar nga Sandy".

"MTA bëri një punë të mrekullueshme në shërbimet restauruese për klientët tanë pas dëmeve më të këqija që ka pësuar ndonjëherë rrejti ynë i transportit, por ne ende po punojmë shumë në prapaskenë për të zëvendësuar pajisjet e dëmtuara, për të rindërtuar infrastrukturën dhe për të restauruar sistemin në formën që ka qenë përpara goditjes së Sandy", tha kryetari i komanduar i MTA, Fernando Ferrer. "Ky fond i ri është një deklaratë e fortë mbështetjeje për përparimin tonë nga qeveria federale".

Sistemi i MTA pësoi një humbje që vlerësohet në 4.755 miliard dollarë dëme në linjat hekurudhore dhe të metrosë, tunelet e automjeteve, stacionet e metrosë si dhe aparaturat elektrike dhe të sinjalistikës të cilat u përmbytën gjatë Sandy-t nga uji i kripur me veti gërryese.

Ndërsa riparimet e përkohshme kanë bërë që të funksionojë pjesa më e madhe e sistemit MTA, linja e metrosë e Rockaways duhet të ndërtohet plotësisht përpara hapjes së parashikuar në verë. Stacioni i metrosë i South Ferry u shkatërrua dhe do të duhen vite për rindërtimin e tij, por stacioni ndërlidhës atje

do të rihapet në javën e parë të prillit. Nëntë nga tunelet e metrosë nën East River dhe Newtown Creek u përmbytën nga uji i kripur, ashtu sikurse edhe disa kantiere dhe stacione terminale të metrosë.

Hekurudha e Long Island pati dëmtime jashtëzakonisht të mëdha në degën e vet të Long Beach Branch, ku si kompleksi i terminalit dhe kantieri u përmbytën nga një përzierje e ujit të kripur dhe ujërave të zeza nga një impiant përpunimi aty pranë. Hekurudha Metro-North pësoi dëme të rëndësishme në sistemin elektrik dhe atë të sinjalistikës përgjatë shinave hekurudhore që ndodhen në ultësirë. Urat dhe tunelet u përmbytën gjerësisht si në tunelet Hugh L. Carey (ish Brooklyn-Battery) ashtu dhe Queens Midtown.

Projektet e MTA do të marrin fonde të tjera në muajt e ardhëm për projektet kritike të riparimit dhe restaurimit, si dhe masat për zbutjen dhe qëndresën nga programi i FTA për Lehtësimin e Emergjencave. MTA do të aplikojë gjithashtu pranë FEMA për fonde federale shtesë për punën rimëkëmbëse në shtatë ura dhe dy tunele.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shteti i Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418